



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:100549

Datë: 23.04.2024

Numri i dokumentit: 05610922

KP.nr. 16/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen juridike të Paditësit "F.C. PRISHTINA" Sh.p.k me NUI 810518607, me seli në Rrugën " F. Agani" Prishtinë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Avokat Apolona Sylja me seli në Prishtinë, kundër të paditurit " Komuna e Prishtinës" me seli në Prishtinë, me objekt kontesti vërtetimi i pronësisë, jashtë seance, më datën 23.04.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore, për të gjykuar në çështje kontestimore me numër KP.nr.16/24, në mes të paditësit F.C. PRISHTINA" Sh.p.k, kundër të paditurit Komuna e Prishtinë, me objekt kontesti vërtetimi i pronësisë.
- II. Pas plotfuqishmërisë se këtij Aktvendimi lënda se bashku me shkresat e saj t'i dorëzohet Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm.

A r s y e t i m

Paditësi F.C. PRISHTINA" Sh.p.k përmes të autorizuarit, me datën 29.03.2024, pranë kësaj Gjykate ka ushtuar padi, ndaj të paditurit Komuna e Prishtinës, me objekt kontesti vërtetimi i pronësisë.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të padisë, vlerësoj se Departamenti i Përgjithshëm pranë Gjykatës Komerciale nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për të gjykuar këtë çështje.

Gjykata erdhi në përfundim se nuk është e kompetencës lëndore për të gjykuar këtë çështje, mbështetur në nenin 13, par 1. lidhur me par. 1.7 të Ligjit për Gjykatën Komerciale (Ligji nr. 08/L-15) i cili përcakton: *“1.Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë”*: në vazhdim par. 1.7 *”kontestet në mes shoqërive tregtare lidhur me të drejtat sendore, siç është e paraparë me Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare”*.

Mbështetur në dispozitat e lartcekura, Departamenti i Përgjithshëm pranë Gjykatës Komerciale është kompetent për shqyrtimin e kontesteve në mes të shoqërive tregtare të përcaktuar në Ligjin për Shoqëri Tregtare, në këtë çështje juridike, palë e paditur nuk është shoqëri tregtare e përcaktuar në Ligjin për Shoqëri Tregtare, por person juridik publik, prandaj bazuar në nenin 12 dhe 20 të Ligjit për Gjykata (Ligji nr. 06/L-054), si dhe bazuar në nenin 41 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (Ligjit Nr.03/L-006), i cili përcakton *“Për gjykim në kontestet lidhur me pronësinë dhe të drejtat sendore të tjera mbi sendet e paluajtshme, në kontestet për shkak të pengim posedimit mbi sendin e paluajtshëm, si dhe në kontestet nga raportet e qiradhënies së paluajtshmërisë, ose nga kontratat për shfrytëzimin e banesave apo të lokaleve të punës, është ekskluzivisht kompetente gjykata në territorin e të cilës ndodhet paluajtshmëria.”*. Meqenëse objekt kontesti është vërtetimi i pronësisë, e sipas kësaj dispozite është e rregulluar kompetenca territoriale ekskluzive, kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje është Gjykata Themelore Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm.

Gjykata bëri shqyrtimin e kompetencës lëndore sipas detyrës zyrtare mbështetur në nenin 17 dhe 19 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Prandaj, bazuar në nenet 17 dhe 19 të LPK-së lidhur me nenin 13 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, nenit 12 dhe 20 të Ligjit për Gjykatat, dhe konform nenit 392 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti i Përgjithshëm
KP.nr.16/24, datë 23.04.2024

Gjyqtari
Gent Bekeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.